



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT  
TIRANE

Nr. 2604 Akti.

Nr. 2449 Vendimi.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Apelit Tirane e perbere prej:

KRYESUESE: Maria QIRJAZI  
ANETAR: Ridvan HADO  
ANETAR: Evjeni SINOJMERI

Ne seancen gjyqesore te dates 02.12.2015, asistuar nga sekretare gjyqesore [REDACTED], mori ne shqyrtim çeshtjen civile me nr.Akti 2604, qe i perket paleve ndergjyqese:

**PADITËS:** [REDACTED], i biri i [REDACTED] i dtl. [REDACTED] lindur ne [REDACTED] dhe banues ne [REDACTED], me adrese: Blv. [REDACTED], Njesia [REDACTED] Pll. [REDACTED] Shk. [REDACTED] Ap. [REDACTED] perfaqesuar me prokure nga i ati [REDACTED]

**TE PADITUR:** Shoqeria "[REDACTED]" sha: me NIPT [REDACTED] me adrese: Rr. [REDACTED], pallati i ri [REDACTED] nr. [REDACTED] perballe ish parkut te mallrave, perfaqesuar ne gjykim nga av. [REDACTED]

**OBJEKTI:**

- Konstatimi i pavlefshmerise se zgjidhjes se kontrates se punes, si dhe detyrimi i punedhenesit per dhenien e demshperblimit ne masen e nje viti page.
- Demshperblim per diskriminim ne pune; kompensim i demit jopasuror per mosrespektim, cenimin dhe mosmbrojtjen ne raportet e punes te personalitetit te punemarresit me gjobe deri ne pesedhjetefishin e pages

minimale mujore per shkelje te te drejtave te punemarresit, te sanksionuara ne nenet 9,10,10/1,32,201 dhe 202/1,2 te Kodit te Punes.

-Pagimi i pagave mujore per te gjithë periudhen kohore nga zgjidhja e kontrates deri ne perfundimin e gjykimit, duke mbajtur parasysh qe lidhur me keto paga si dhe persa i perket demshperblimit per prishje te pajustificuar te kontrates se punes, vendimi i gjykates te jepet me ekzekutim per kohshem.

**BAZA LIGJORE** : “Deklarata Universale e te Drejtave te Njeriut” e dates 10 Dhjetor 1948; Neni 14 i Konventa Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut”; Karta e Parisit per nje Europe te Re”, Nenet 15/1, 16/2, 17, 18/1,2, 22/1, 23/1, 25, 35/3, 42/1, 44, 49/2, 50 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; Nenet 114, 608 – 610, 618, 625, 676, 677, 681, 686, 690, 693, 696/3, 699 dhe 703 te K.Civil i Republikes se Shqiperise; Nenet 5, 6, 12, 13, 16, 19, 20, 22, 25, 28, 29, 31, 32, 35, 36, 47, 65, 68, 92, 96, 97, 99, 102, 104, 106, 117, 118, 141 (paragrafi dy), 153, 154/a, 156, 158/a, 158/b, 179, 180, 182, 183, 185, 198, 213, 246, 259, 268, 277, 297, 325, 422, te K.Pr.Civile; Nenet 9, 10/1, 12, 19/1, 21/1, 23/2,3; 32/1,2; 92, 93, 94/5 dhe 144/3 te K.Punes; Nenet 2, 3, 4, 5, 7, 12, 13, 15, 21 dhe 32 deri 38 te ligjit nr. 10221 date 4.2.2010 “per Mbrojtjen nga Diskriminimi”; Nenet perkatese te ligjit nr. 49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, qe kane zevendesuar nenet 324 deri 333 te shfuqizuara te ligjit K.Pr.Civile te Republikes se Shqiperise; Vendimi nr.33 i vitit 2007 te Gjykates Kushtetuese te Republikes se Shqiperise; Vendim Unifikues nr.19, date 15.11.2004 i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte.

**Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me vendimin nr.10999, date 14.11.2014, ka vendosur:**

1. *Pranimin e pjesshem te padise se paditesit [REDAKTUAR]*
2. *Detyrimin e te paditurit Shoqeria “[REDAKTUAR]” sh.a te paguaje paditesin [REDAKTUAR] me 12 dite page si leje zakonshme per vitin kalendarik 2013.*
3. *Rrezimin e padise per pjesen tjeter te kerkimeve.*
4. *Shpenzimet gjyqesore ne paleve ne perpjestim me pranimin e padise.*

**Kunder ketij vendimi ka bere ankim paditesi duke parashtruar shkaqet per ndryshimin e vendimit, si dhe ankim kundertshtues pala e**

paditur, duke parashtruar shkaqet per mospranimin e ankimit:

Paditesi [REDACTED] parashtron ne ankim shkaqet per ndryshimin e vendimit, si:

- vendimi i gjykates se shkalles se pare eshte i padrejte;
- vendimi ka gabime te renda proceduriale si dhe mungese ne arsyetimin ligjor te vendimit, pasi nuk i ka dhene zgjidhje efektive kerkesave te pales paditese;
- dy bashkepaditesit [REDACTED] dhe [REDACTED] kane paditur punedhenesin e perbashket per prishje te pajustificuar te kontrates se punes dhe gjykata ka vendosur ndarjen e grupit te paditesve dhe shqyrtimin vec e vec te se njejtse padi;
- referuar nenit 470 te K.Pr.Civile bashke me ankimin e vendimit perfundimtar ankimojme edhe vendimin e ndermjetem per ndarjen e paditesave;
- zgjidhja e kontrates se punes konsiderohet e justifikuar kur provohet mosrespektimi i kontrates se punes nga pala tjetere, por pala e paditur asnjehere nuk pretendoi se e ka zgjidhur kontraten e punes per shkaqe te justifikuara;
- pala e paditur nuk ka pasur asnje shkak te justifikuar, por thjesht "deshire";
- me date 20.01. 2014 punemarresi [REDACTED] pasi ka dorezuar "kufjet personale" verbalisht i kerkoj punedhenesit, njoftimin me shkrim lidhur me vendimin e marre per zgjidhjen ose jo te kontrates se punes;
- pala e paditur ne séance gjyqesore i dha gjykates kopje te vendimit te zgjidhjes se kontrates se punes, duke pretenduar se ja ka dorezuar punemarresit me poste, por duhej te konfirmohej njoftimi nepermjet hedhjes se firmes;
- i padituri ka pretenduar se e ka derguar njoftimin me poste ne adresen e punemarresit, por qe prej 2012-tes paditesi banon tek Unaza e re, dhe ndaj njoftimin nuk e ka marre;
- paditesi i ka kerkuar disa here te paditurit t'ja jepte dorazi vendimin kundrejt firmes se tij, por kerkesa i eshte refuzuar;
- sipas nenin 144 pika 5/1 te K.Punes, i takon punedhenesit te vertetoje qe procedura e percaktuar nga ky nen eshte respektuar;
- me dt 09.01.2014 punedhenesi ka njoftuar me akt shkresor per tu takuar dhe biseduar me punemarresin, ku rezulton se i padituri nuk i ka parashtruar punemarresit arsyet e vendimit te parashikuar per t'u marre;
- prova audio e regjistrimit te bisedes provon se punedhenesi ka deklaruar se nuk kishte shkak per zgjidhjen e justifikuar te kontrates se punes;
- ne rastin kur zgjidhja e kontrates se punes ne menyre te menjehershme eshte bere pa shkaqe te justifikuara, gjykata duhet te vendoste detyrimin e punedhenesit per nje demshperblim ndaj punemarresit prej jo me shume se

paga e nje viti pune;

-i padituri per te penguar organizimin paraprak per krijimin *de facto* te sindikates se operatoreve, zgjidhi pa shkak te justifikuar kontraten e punes me nen kryetarin e grupit drejtues te punes dhe kryetarin e saj, respektivisht dy bashkepaditesit ne padine objekt gjykimi;

-per te rrezuar kerkesen e paditesit lidhur me ushrimin e diskriminimit nga ana e punedhenesit, pasi "*de facto*" ka krijuar sindikaten, gjykata eshte shprehur se sindikata nuk ka ekzistuar, pasi nuk eshte regjistruar sipas ligjit;

-provat e paraqitura nga pala paditese jane te fallsifikuara dhe per kete shkak ne i kerkuam gjykates t'i shpall ato te fallsifikuara dhe te pezulloje gjykimin, por gjykata e ka refuzuar respektimin e procedures;

-pala paditese ka provuar ne gjykim se pala e paditur i detyrohet 12 dite leje per vitin 2013, plus 5 dite per 2014 si dhe pagesen e raportit mjekesor 5 ditore;

-kerkojme ndryshimin e vendimit dhe pranimin plotesisht te kerkese-padise.

Pala e paditur shoqeria '████████' sh.a, parashton ne kunder ankim, se:

-vendimi i gjykates se shkalles se pare eshte i drejte;

-pretendimet e paditesit ne ankim nuk qendrojne;

-me dt 09.01.2014 punedhenesi i ka komunikuar me poste punemarresit qellimin per zgjidhjen e kontrates, provuar me deftesen postare te TNT nr. 452683, ku konfirmohet marrja dijene nga paditesi;

-me dt 13.01.2014 eshte bere takimi me paditesin dhe eshte biseduar ne lidhje me qellimin e shoqerise per zgjidhjen e kontrates se punes, ne fund punedhenesi ka kerkuar nenshkimin e punemarresit per process-verbalin e takimit, por ai ka refuzuar ta nenshkruaj;

-bazuar ne nenin 144 te K.Punes, brenda 48 oreve deri ne nje jave mbas takimit, shoqeria ka vendosur te zgjidhe kontraten;

-vendimi per zgjidhjen e kontrates i eshte komunikuar paditesit, i cili ka marre njoftim rregullisht, vertetuar me deftesen postare te TNT nr. 232600;

-shoqeria ka respektuar te gjithe proceduren per zgjidhjen e kontrates se punes, duke i akorduar paditesit afatin e njoftimit prej 2 muajsh (neni 143 I K.Punes) dhe shperblimin per pushimet e fituara dhe te pa marra;

-referuar vendimit unifikues nr.19 dt. 15.11.2007, palet nese respektojne proceduren dhe afatin e njoftimit, mund ta zgjidhin kontraten pa dhene ndonje arsye;

-paditesi nuk paraqiti asnje prove per te vertetuar zgjidhjen e kontrates se punes per shkaqe abusive, dhe as per te vertetuar se ka ekzistuar apo ekziston ndonje sindikate ne shoqerine "████████";

-ne lidhje me diskriminimin qe pretendon paditesi te jete kryer ne dem te tij, verejme se nuk solli asnje prove, dokument apo fakt per te mbeshtetur kete pretendim;

- paditesi pretendon se zgjidhja e kontrates se punes eshte bere ne kohe te papershtatshme, pasi punemarresi kishte raport mjekesor per 5 dite pushim nga dt 16.01.2014 deri me 21.01.2014, por punemarresi nuk e ka dorezuar raportin tek shoqeria, dhe qellimisht nuk i eshte njoftuar shoqerise, per te pretenduar zgjidhjen e kontrates ne kohe te papershtatshme;
- kerkojme lenien ne fuqi te vendimit te shkalles se pare.

## GJYKATA E APELIT TIRANE

- Pasi degjoi relatimin e gjyqtares Maria Qirjazi;
- degjoi perfaqesuesin e pales paditese, z. [REDACTED], qe kerkoj ndryshimin e vendimit per pjesen e rrezuar te padise, duke e pranuar ate ne teresi sipas objektit;
- degjoi perfaqesuesin e pales se paditur, Av. [REDACTED], qe kerkoj lenien ne fuqi te vendimit;
- pasi shqyrtoi çeshtjen ne teresi,

### V Ë R E N:

Paditësi [REDACTED] ka paraqitur për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane, kërkesë-padinë ndaj të paditurit [REDACTED] sh.a, me objekt "Dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme te pajustificuar të kontratës së punës".

Ne baze te provave te administruara ne gjykimin e ceshtjes, ka rezultuar se:

-paditesi ka qene i punesuar prane pales se paditur [REDACTED] sh.a, qe ushtron veprimtari tregtare si "Call Center", në detyren e "operatorit". Marrëdhënia e punës midis palëve ka filluar me date 27.06.2011, duke vazhduar pa nderprerje deri ne daten 16.03.2014.

Rezulton se kontrata e punes mes paleve eshte zgjidhur sipas aktit Nr.1601/2014 prot. te te paditurit [REDACTED] sh.a, i cili i ka komunikuar paditesit nderprerjen e marredhenies se punes dhe asaj financiare ne daten 16.03.2014.

Paditësi [REDACTED] duke mos qene dakort me zgjidhjen e kontrates se punes nga i padituri punedhenes, ka paraqitur padine objekt shqyrtimi ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Sipas paditesit, zgjidhja e kontrates se punes nga punedhenesi i paditur, eshte bere pasi ka patur dijeni per veprimin sindikalist te paditesit dhe organizimin de facto te Sindikates "[REDACTED]" sha, e cila eshte nismuar dhe organizuar nga ana e grupit te vecante te punemarresve, te kryesuar nga paditesi [REDACTED]. Paditesi ka pretenduar se ai eshte diskriminuar nga punedhenesi, per shkak se kryente veprimtari sindikaliste dhe kishte formuar

defacto sindikaten e operatoreve te [REDACTED] sha.

Paditesi ka pretenduar ne gjykim gjithashtu se veprimtaria organizative pergatitore e grupit nismetar te kryesuar nga [REDACTED] dhe [REDACTED] eshte paraprire nga ngritja permanente e problematikave te : gjobave ne mase ndaj operatoreve, pa motivacion, presionit gjate punes nga supervizoret, i shoqeruar me mungese etike profesionale, e drejta e pageses financiare per pushimin e trete, vendosja e gjobave edhe per shkak te kryerjes se nevojave persoanle ndaj operatoreve, pezullimi nga puna per nje periodhe prej 2 javesh, kur ne baze te rregullores ky pezullim nuk mund te jete me shume se 3 dite.

Paditesi i kerkoi gjykates qe te perjashtojte nga provat fotokopjen e dokumentit te noterizuar [REDACTED] sha, si dhe perkthimin e tij, pasi pretendoi se eshte i fallsifikuar.

Paditesi pretendoi gjithashtu se nuk i jane paguar 12 dite leje e zakonshme per vitin kalendarik 2013.

Sipas paditesit, i padituri [REDACTED] sh.a, e ka prishur kontraten ne kohe te papershtatshme, pasi ai ishte me raport mjekesor 5 ditor, leshuar nga institucioni shendetesor i lagjes nr.3 Tirane, me dt.16.01.2013.

Sa me siper, nga ana e paditesit eshte kerkuar qe te detyrohet pala e paditur te paguaje demshperblim me pagen e nje viti pune, si dhe per moszbatim te procedures se pushimit nga puna te punemarresit, ne baze te nenit 144 te K.Punes, t'i paguaje paditesit nje demshperblim ne masen e dy pagave mujore, si dhe t'i paguaje 17 dite leje te zakonshme dhe 5 dite raport mjekesor te papaguar.

Paditesi pretendoi gjithashtu se, pala e paditur nuk i ka paguar pushimin e trete, ne masen 11' e 15'' cdo dite pune, 67' e 15'' cdo jave, 4 ore e 51' cdo muaj: gjithsej 150 ore e 21', per 31 muaj, ne vleren 42.000 leke.

Gjithashtu, paditesi ka pretenduar se bazuar ne ligjin per mbrojtjen nga diskriminimi, per shkak te ushtrimit te diskriminimit ne pune, gjykata duhet te vendose gjobe deri ne 50(pesedhjete) fishin e pages minimale mujore ndaj punedhenesit [REDACTED] sh.a, e cila te kaloje si demshperblim ne favor te paditesit [REDACTED], per te kompesuar diskriminimin dhe demin moral, etik dhe jopasuror te tij.

Perfaqesuesi i pales se paditur ka pretenduar ne gjykim se pushimi nga puna i paditesit nga i padituri eshte bere ne baze te nenit 141 te K.Punes, eshte zbatuar procedura dhe afati i njoftimit per paditesin, sipas neneve 143 dhe 144 te K.Punes.

Pala e paditur pretendon se nuk qendron pretendimi i paditesit se kontrata eshte zgjidhur ne kohe te papershtatshme, pasi i padituri eshte vene ne dijeni shume kohe me pas per ekzistencen e raportit mjekesor. Sipas te

paditurit, nga vertetimi noterial i ketij raporti, rezulton se origjinali i Raportit mjekesor ka qene paraqitur per kryerjen e veprimit te njehsimit me origjinalin ne noteri me dt.25.03.2014, pra deri ne ate dite raporti origjinal ka qene ne posedim te paditesit dhe nuk eshte dorezuar ndonjehere ne shoqerine [REDACTED] sha.

Lidhur me pretendimin e paditesit se i ka paraqitur gjykates per te vertetuar ekzistencen e sindikates disa akte shkresore, i padituri parashtroi se paditesi nuk paraqiti asnje akt zyrtar qe te vertetonte ekzistencen, ne baze te nenit 177 te K.Punes, te Sindikates se [REDACTED] sha. Sipas nenit 177 te K.Punes, akti i krijimit te cdo organizate sindikale duhet te nenshkruhet nga jo me pak se 5 anetare themelues per organizaten e punedhenesve, dhe jo me pak se 20 anetare themelues per organizaten e punemarresve.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor, në baze te provave e administruara ne séance gjyqesore ka çmuar se:

-punëdhënësi (i padituri) më datë 16.03.2014, ka zgjidhur ne menyre te njeanshme kontratën e punës me punëmarrësin (paditësin) [REDACTED], duke zbatuar proceduren dhe afatin e parashikuar nga nenet 144 dhe 143 te K.Punes.

Ne baze te nenit 140 te K.Punes eshte parashikuar se: *''Kontrata me kohezgjatje te pacaktuar, perfundon kur zgjidhet nga njera pale dhe ka perfunduar afati i njoftimit''*.

Gjithashtu, bazuar edhe ne konkluzionet unifikuese te Vendimit te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte Nr. 19 dt.15.11.2007, detyrimi i pales qe zgjidh kontraten ne menyre te njeanshme, eshte te realizoje procedurat e njoftimit, ne respektim te neneve 143 dhe 144 te K.Punes. Sikurse eshte saktësuar ne kete vendim unifikues: *''..respektimi i kerkesave te nenit 141, 143, 144, 145 te K.Punes nga punedhenesi, si rregull, passjell perfundimin ne menyre te natyrshme te kontrates se punes dhe respektimin e te gjitha te drejtave te punemarresit..''*.

Nga ana e Gjykates se Rrethit eshte vlerësuar se nga ana e te paditurit eshte zbatuar neni 143 i K.Punes, i cili ka te beje me afatet e njoftimit per zgjidhjen e kontrates se punes. Ne kushtet qe paditesi ka qene ne vitin e tij te trete te punes, i padituri e ka njoftuar paditesin dy muaj para per zgjidhjen e kontrates se punes. Me shkresen e dates 16.01.2014, punedhenesi ka njohur paditesin se marredheniet e punes dhe ato financiare do te perfundonin dy muaj pas njoftimit te zgjidhjes se kontrates se punes, ne date 16.03.2014. Ne gjykim u vertetua se nga ana e punedhenesit te paditur eshte bere pagesa mujore e paditesit per dy muajt e afatit te njoftimit per zgjidhje te kontrates se punes.

Ne keto kushte, cmohetn se drejte Gjykata e Rrethit ka konkluduar se kontrata e punes mes paleve ne gjykim eshte zgjidhur ne menyre te

njeanshme dhe ne perfundim te afateve te njoftimit nga punedhenesi i paditur, sipas parashikimeve te neneve 141 dhe 143 te K.Punes.

Gjithashtu, Gjykata e Rrethit ka vleresuar se ne baze te nenit 144 te K.Punes, i padituri ne cilesine e punedhenesit vertetoi ne gjykim se ka zbatuar proceduren e zgjidhjes se kontrates se punes me paditesin.

Gjykata e Rrethit ka vleresuar se paditesi eshte njoftuar ne date 13.01.2014, dhe eshte paraqitur ne takimin e planifikuar te zhvillohej, sipas parashikimeve te nenit 144 te K.Punes, e ne keto rrethana gjykata ka cmuar se ky kerkim i padise duhet te rrezohet.

Porse Gjykata e Apelit konstaton se pa te drejte Gjykata e Rrethit ka vleresuar se pala e paditur punedhense ka respektuar proceduren ligjore te zgjidhjes se kontrates se punes me paditesin. Ne baze te nenit 144 te KPunes, pika 3) **Zgjidhja njoftohet me shkrim brenda nje afati nga 48 orë deri ne nje jave pas takimit.**

Nga aktet ne dosje nuk rezulton qe paditesi [REDACTED] te jete njoftuar me shkrim per zgjidhjen e kontrates se punes, ne baze te kerkesave ligjore. Pala e paditur ka pretenduar se ka kryer njoftimin me ane te postes TNT, duke paraqitur edhe shkresen perkatese te njoftimit, porse sipas kesaj shkrese nuk rezulton qe ajo te permbaje nenshkrimin e marresit (paditesit).

Në keto kushte, Gjykata e Apelit cmon se nga Gjykata e Shkalles se Pare pa te drejte eshte vleresuar se pala e paditur ka respektuar proceduren ligjore per zgjidhjen e kontrates se punes me paditesin. Per rrjedhoje, cmohet se vendimi i dhene duhet ndryshuar per kete pjese, duke vendosur detyrimin e pales se paditur Shoqeria "[REDACTED] sh.a, ti paguaj paditesit [REDACTED] demshperblim ne masen e 2 pagave mujore per shkak te mosrespektimit te procedures se zgjidhjes se kontrates se punes.

Ne lidhje me kerkimin e paditesit per konstatimin nga gjykata te shkakut abuziv qe ka sjelle prishjen e kontrates se punes mes paleve, referuar nenit 146/1,e te K.Punes, Gjykata e Rrethit ka cmuar se ky kerkim rezulton i pabazuar ne prova. Paditesi pretendoi se eshte diskriminuar per veprimin sindikalist dhe organizimin de facto te Sindikates "[REDACTED] sha, e cila eshte nismuar dhe organizuar nga ana e grupit te vecante te punemarresve te kryesuar nga paditesi [REDACTED] dhe z. [REDACTED]

Gjykata e Rrethit ka cmuar se nuk ka rezultuar e vertetuar se ka ekzistuar apo se ekziston ndonje Sindikate e shoqerise [REDACTED] sha., ne referim te nenit 176 e vijues te K.Punes, e per rrjedhoje gjykata ka cmuar se edhe referenca e paditesit ne nenin 146 te K.Punes eshte e pabazuar. Sikurse rezultoi ne gjykim, vete paditesi e ka vene ne dijeni punedhenesin e tij per pergatitjen per krijimin e nje sindikate te punemarresve te [REDACTED] sha, vetem gjate bisedimeve te ndodhura ne dt.13.01.2014, kur ky i fundit i kishte komunikuar se do te bente zgjidhjen e marrdhenies se punes me



paditesin, ne perfundim te afateve te njoftimit.

Sa me siper, cmohet se Gjykata e Rrethit drejte i ka vleresuar veprimet e paditesit si veprime pergatitore per krijimin e sindikates, dhe ne kuptim te ligjit nuk mund te konsiderohet nga gjykata si veprimtari sindikale, perderisa kjo sindikate e pretenduar nuk ka ekzistuar dhe nuk ishte regjistruar sipas ligjit.

Ne degjimin e bisedes te zhvilluar ne takimin mes punedhenesit dhe punemarresit ne date 13.01.2013, te regjistruar nga paditesi dhe te paraqitur si prove ne gjykate, rezulton se vetem ne kete date paditesi i ka dorezuar perfaqesuesit te punedhenesit kater dokumente shkresore ne te cilat e vinte ne dijeni per kete veprimtari sindikale: Metime; Programi i Sindikates '██████ sha; Statuti i Sindikates ██████ sha; Proces Verbali i mbledhjes themeluese te Sindikates '██████ sha.

Sa me siper, gjykata e rrethit drejte ka konstatuar se zgjidhja e kontrates se punes nga i padituri, nuk u vertetua se eshte bere per shkak te anetaresimit te punemarresit ne sindikate, e krijuar sipas ligjit, ose per shkak te pjesmarrjes ne veprimtari sindikale ne baze te ligjit, pra nuk rezulton te jete bere per shkak abuziv sipas parashikimit te nenit 146 te K.Punes, dhe drejte eshte cmuar se ky kerkim i padise duhet te rrezohet.

Per rrjedhoje, cmohet se drejte gjykata e rrethit ka rrezuar edhe pretendimin e paditesit se, per shkak te ushtrimit te diskriminimit ne pune gjykata duhet te vendose gjobe deri ne 50(pesedhete) fishin e pages minimale mujore ndaj punedhenesit ██████ sh.a, e cila t'i kaloje si demshperblim paditesit ██████

Gjithashtu, Gjykata e Rrethit drejte arsyeton ne vendimin e saj se nuk u vertetua ne gjykim se ██████ sh.a, nuk ka paguar paditesin per pushimin e trete prej 11' e 15'' cdo dite pune, gjithsej 150 ore e 21' per 31 muaj, gjithesej 42.000 leke, referuar nenit 6 te Kontrates se punes dt.1.08.2011 te lidhur mes paleve.

Per sa i perket kerkimit te paditesit, qe bazuar ne ligjin per mbrojtjen nga diskriminimi, per gjobitje te te paditurit punedhenes, cmohet se drejte eshte vleresuar nga gjykata e rrethit si nje kerkim i pabazuar ne ligj e prova.

Gjykata e Rrethit ne lidhje me kerkesen per pagimin e lejes vjetore te pamare, ne masen e 12 diteve, ka cmuar se nga aktet ne dosje nuk rezulton qe i padituri te kete paguar lejen vjetore per vitin 2013, dhe ne keto rrethana ky kerkim i padise duhet pranuar.

Ndersa lidhur me kerkimin per pagesen e raportit mjekesor, nga gjykata e rrethit drejte eshte vleresuar si i pabazuar, pasi nuk rezultoi i provuar qe t'i jete dorezuar punedhenesit.

Ne lidhje me kerkimin e paditesit per perjashtimin ne cilesine e proves te aktit shkresor '████████████████████ sha'', si nje akt i falsifikuar, jo vetem qe nuk rezultoi e provuar, nderkohe qe paditesi kishte detyrimin per

te paraqitur provat per te vertetuar pretendimin e tij per falsitet, porse Gjykata e Rrethit drejte ka cmuar se kjo prove nuk ka lidhje me objektin e gjykimit.

Sa me siper, ne lidhje me pretendimet e ngritura ne ankimin e pales paditese, Gjykata e Apelit cmon se ato jane pjeserisht te bazuara ne ligj e ne prova.

Gjykata e Apelit e gjen pjeserisht te drejte vendimin e dhene nga Gjykata e Shkalles se Pare.

Drejte eshte vleresuar nga Gjykata e Shkalles se Pare, se pala e paditur ka zgjidhur kontraten e punes me paditesin duke respektuar afatin e njoftimit, qe ne rastin konkret ka qene dy muaj ne baze te nenit 143 te KPunes. Pra ne kete rast nuk kemi te bejme me zgjidhje te menjehershme te kontrates se punes, per te vleresuar shkaqet e justifikuara ose jo te zgjidhjes se kontrates se punes.

Porse Gjykata e Apelit konstaton se, pa te drejte Gjykata e Rrethit ka vleresuar se pala e paditur punedhenese ka respektuar proceduren ligjore te zgjidhjes se kontrates se punes me paditesin, ne baze te nenit 144/3 te KPunes. Nga aktet ne dosje nuk rezulton qe paditesi [REDACTED] te jete njoftuar me shkrim per zgjidhjen e kontrates se punes, ne baze te kerkesave ligjore. Pala e paditur ka pretenduar se ka kryer njoftimin me ane te postes TNT, duke paraqitur edhe shkresen perkatese te njoftimit, porse sipas kesaj shkrese nuk rezulton qe ajo te permbaje nenshkrimin e marresit (paditesit).

Ne lidhje me pretendimet e tjera te ngritura ne ankimin e pales paditese, Gjykata e Apelit cmon se ato nuk jane te bazuara ne ligj e ne prova. Cmohet se Gjykata e Rrethit ka analizuar drejte te gjitha pretendimet e pales paditese, duke i dhene pergjigje te drejte e te bazuar ne ligj e ne prova.

Në keto kushte, Gjykata e Apelit cmon se vendimi i dhene nga Gjykata e Shkalles se Pare duhet lene ne fuqi per pjesen e pranuar te padise, dhe duhet ndryshuar per pjesen tjeter, duke vendosur detyrimin e pales se paditur Shoqeria [REDACTED] sh.a, ti paguaj paditesit [REDACTED] edhe demshperblim ne masen e 2 pagave mujore per shkak te mosrespektimit te procedures se zgjidhjes se kontrates se punes.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata e Apelit Tirane, ne baze te nenit 466/a,b te K.Pr.Civile,

#### **V E N D O S I :**

-Lenien ne fuqi te vendimit civil nr.10999, date 14.11.2014, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me kete ndryshim:

-Detyrimin e pales se paditur Shoqeria [REDACTED] sh.a, ti paguaj paditesit [REDACTED] demshperblim ne masen e 2 pagave mujore per shkak te mosrespektimit te procedures se zgjidhjes se kontrates se punes.

Kunder vendimit lejohet rekurs ne Gjykatën e Lartë.  
U shpall ne Tirane, sot me date 02.12.2015

**ANETAR**

**Evjeni SINOJMERI**  
dv

**ANETAR**

**Ridvan HADO**  
dv

**KRYESUESE**

**Maria QIRJAZI**  
dv

**Vertetohet njesia me origjinalin**

**Kancelar**

**ARBER KUSHE**

